

PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË TAKIMIT
KËSHILLI KOMBËTAR PËR EKONOMI DHE INVESTIME (KKEI)

TAKIM I RREGULLT, II

Prishtinë, 7 maj 2024, 10:00 – 12:40

Takimi u kryesua nga Kryeministri Albin Kurti, ndërsa u moderua nga Artan Mehmeti, Udhëheqës i Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime. Në takim morën pjesë 22 anëtarë dhe rreth 40 vëzhgues. Pjesëmarrës ishin përfaqësues të shoqatave vendore të biznesit, të organizatave të huaja, dhe institucioneve shtetërore në Kosovë.

Fjalët hyrëse

Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI, në fjalën e tij hyrëse falenderon Kryeministrin Kurti, anëtarët e kabinetit qeveritar, stafin, institucionet vendore, përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare, odat dhe shoqatat përfaqësuese të biznesve vendore për pjesëmarrje në takimin e KKEI, dhe për bashkëpunimin e përgjithshëm për dialog publiko-privat. Ai tutje theksoi qëllimin e takimit, që shërben për të përafuar institucionet publike dhe sektorin privat, e që në këtë mënyrë të mundësojë fasilimin e reformave që kanë të bëjnë me klimën investive dhe mjedisin e të bërit biznes në Kosovë. Udhëheqësi i Sekretariatit shtoi se ky takim mundëson edhe diagnostikimin më të mirë të rekomandimeve, hartimin e politikave dhe reformave.

Z. Mehmeti poashtu informoi se Sekretariati i KKEI pas takimit të fundit të Këshillit ka organizuar një sërë raundesh të diskutimeve mes sektorit privat dhe institucioneve publike të ndara në forume sektoriale, ku kanë marrë pjesë institucionet publike, përfaqësues të bizneseve, odave, shoqatave, OJQ-të dhe organizatat të ndryshme ndërkombëtare në mënyrë që të diagnostikohen rekomandime dhe kërkesa të sektorit privat. Disa nga ato rekomandime, por edhe ato të ngritura në nëntor apo gjatë takimit të fundit të Këshillit në muajin shkurt, do të shtjellohen në takimin e sotëm.

Kryeministri Albin Kurti, Kryesues, KKEI, pasi falenderoi të gjithë pjesëmarrësit për angazhimin në dialog-publiko-privat, fjalën e tij hyrëse e nisi me një vërtetim rreth këtij dialogu, duke e cilësuar të njëjtin si platformë për pjesëmarrësit për të mësuar nga njëri-tjetri dhe të komplementuar punën e njëri-tjetrit, ashtu që të bashkohen pikat e forta e të punohet drejt vizionit të përbashkët. Ai theksoi rëndësinë e besimit në dialogun publiko-privat, potencialin për rritje dhe konkurrencë, si dhe rolin e zhvillimit të fuqisë punëtore, me qëllim të fokusit në

mundësitë pro-aktive. Si dëshmi të asaj që mund të arrijmë përmes bashkërendimit ndërinstitucional dhe komunikimit të qartë me bizneset, Kryeministri mori si shembull një nga rezultatet e dukshme të këtij dialogu, e që është angazhimi drejt heqjes së licencës së eksportit për produktet farmaceutike, një pengesë kjo jo tarifore që ka vëshirësuar të bërit biznes për shumë vite me radhë.

Paralelisht me rëndësinë e dialogut, Kryeministri përmendi rëndësinë e fuqisë punëtore. Ai tha se përmes edukimit profesional të fuqisë punëtore plotësohen nevojat e sektorit privat, e synimi është që qytetarët të jenë të përgatitur mirë dhe konkurrues në tregun e punës.

Kryeministri Kurti konfirmoi edhe angazhimin e Qeverisë në strategjitë për rritje të investimeve dhe nivelit të eksportit nga bizneset e Kosovës. Në mesin e tyre, u përmend synimi për praninë gjithmonë e më të madhe të Kosovës në panaire prestigjioze ndërkombëtare, e angazhimi për të plotësuar nevojat për investime për infrastrukturë të re ose për ta përmirësuar atë ekzistuese publike. Si suksese të fundit në këtë drejtim, ai listoi përmbylljen e ankandit të parë diellor prej 100 MW, derisa Qeveria po përgatitet për ankandin e radhës për energji të erës, me kapacitet prej 150 MW. Gjithashtu, përmendi edhe vlerësimin inaugurues të kredisë sovrane të Kosovës nga Fitch Ratings, falë mbështetjes nga USAID-i, si arritje që do të rrisë investimet e huaja, do të ulë kostot e huamarrjes, do të përmirësojë qasjen në tregjet globale të kapitalit dhe do të nxisë edhe më tej rritjen ekonomike të vendit tonë.

Kurti konsideroi se sukseset mes sektorit publik dhe privat nuk janë të ndara. Duke bërë thirrje që ky dialog të jetë dëshmi e besimit tonë të ndërsjellë, por në të njëjtën kohë edhe mundësi për ta rritur këtë besim të ndërsjellë, Kryeministri i falenderoi edhe një herë të gjithë për pjesëmarrje në takimin e sotëm.

Zëvendëskryeministri Besnik Bislimi, i falënderon të pranishmit për pjesëmarrje por edhe gatishmërinë e tyre që të diskutojnë për elementet kryesore të planit të rritjes për Ballkanin Perëndimor, si instrument i ri i zhvilluar nga Komisioni Evropian me qëllim të përsheptimit të procesit të integritit të Ballkanit Perëndimor, drejt Bashkimit Evropian. Ai theksoi se Kosovës i janë ndarë 945 milionë Euro, nga 6 miliardë Euro të ndara nga Bashkimi Evropian për Ballkanin Perëndimor. Nga këto fonde, 50% do të jenë mbështetje direkte buxhetore, pjesa tjetër do të jetë e investime, si dhe pjesa më e madhe është grant, pra mjete që nuk duhet të kthehen në Bashkimin Evropian. Tutje, ai theksoi se negocimi i planit strategjik është nxjerrë nga dokumentet ekzistuese strategjike përmes zyrës së tij, ku janë marrë disa komponente nga plani strategjik zhvillimor, nga strategjia e energjisë, por edhe nga strategjia infrastrukturore. Krahas linjave të vendosura nga Komisioni Evropian, është vendosur se cilat prej reformave do të jenë pjesë e kësaj pakoje, e ato ndahen në pesë fusha:

1. *Qeverisja* – ku do të punohet në dy segmente të kësaj fushe: 1) reforma e mëtejme e administratës publike (avancimi i sistemit transparent të kompensimit, klasifikimit të pozitave nëpër ministri; forcimi i mëtejme i kapaciteteve administrative dhe për monitorim) dhe 2) menaxhimi i financave publike.

2. *Tranzicioni i gjelbër dhe ai digjital* – në kuadër të të cilit synohen jashtëzakonisht shumë reforma, ku përfshihen siguria kibernetike, efienca e energjisë, reforma e tregut, politika e dekarbonizimit, digjitalizimi i shërbimeve në infrastrukturën publike, e shumë reforma të tjera që do ta ngrisin kualitetin e këtij sektori në nivel shumë më të lartë.
3. *Zhvillimi i sektorit privat dhe mjedisi i biznesit* – parashihet komponenta e qasjes në financa për komunitetin e biznesit, themelimi i agjencisë për investime dhe eksport, formimi i ndërmarrjes për ndihmë shtetërore dhe reforma tjera.
4. *Edukimi/zhvillimi dhe ruajtja e kapitalit njerëzor* - do të investohet në dy shtylla të kësaj fushe: 1) në arsim dhe 2) në tregun e punës. Sistemi i arsimit duhet të reflektojë nevojat e tregut të punës, kurse për tregun e punës në fokus janë gratë, të rinjtë dhe grupet e marginalizuara, për të cilët synohet rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës.
5. *Vlerat themelore dhe sundimi i ligjit* – në kuadër të kësaj fushe përfshihen pesë shtylla ku do të investohet në reforma. Këto përfshijnë:
 - 5.1 *Gjyqësori* - synon përmirësimin e performancës së gjyqësorit, ngritjen e integritetit por edhe të llogaridhënies dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë.
 - 5.2 *Luftimi i korrupsionit* – do të ndihmojë në përmirësimin e kornizës strategjike.
 - 5.3 *Luftimi i krimit të organizuar* - ndihmon në përmirësimin e strukturës organizative të policisë, por edhe zbatimin e qasjes strategjike në luftimin e krimit të organizuar.
 - 5.4 *Të drejtat themelore* - si target kanë mbrojtjen nga dhuna në familje dhe në baza gjinore, mbrojtjen e të drejtave të komunitetit joshumicë.
 - 5.5 *Demokratizimi* – kjo fushë çon në përmirësimin e performancës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ministre Artane Rizvanolli, ME, falenderon të pranishmit për pjesëmarrje. Ajo përmendi skemat për eficiencë të energjisë të implementuara nga Ministria e Ekonomisë gjatë muajve të fundit. Ato skema përfshijnë subvencionimin bizneseve për pajisje eficiente për ngrohje (me 30% të bizneseve me pronare gra). Skema tjetër e prezantuar ka qenë për mbështetje të konsumatorëve familjar dhe ndërmarrjeve mikro, të vogla e të mesme për investime në sisteme të ripërtërishme, duke përfshirë sistemin solar fotovoltaik për prodhimin e energjisë elektrike për vetëkonsum. por edhe sistemin solar për ngrohjen e ujit sanitar për ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme. Këto skema janë të financuara nga BE-ja.

Ministrja vazhdoi duke treguar për arritjet gjatë muajit mars 2024, e ato janë: lansimi i bursës shqiptare të energjisë elektrike ALPEX ku do të tregtohet energjia një ditë përpara e që është bashkëdyzim me Shqipërinë. Po ashtu, gjatë këtij muaji, MFPT ka përfunduar marrëveshjen për financimin e parkut solar prej 100MW në pronësi të KEK, ndërsa sipas marrëveshjes tjetër mes Bankës Gjermane për Zhvillim dhe KEK-ut, do të ndërtohen parqe solare prej 200MW, që do rezultojë në krijimin e vendeve të reja të punës. Tutje, Ministrja përmendi se ministri Aliu dhe Qeveria Gjermane kanë nënshkruar partneritetin klimatik dhe të tranzicionit të energjisë, një marrëveshje që Gjermania e nënshkruan me numër të kufizuar të shteteve. Kurse gjatë muajit

prill, Ministrja theksoi se në Kuvend është miratuar Ligji i parë për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë. Kjo e vendos Kosovën të parën në rajon për nga korniza ligjore në këtë fushë.

Ministrja Rizvanolli tha se përgjatë viteve të ardhshme do të investojnë edhe 70 milionë Euro të tjera në sektorin e energjisë eficiente në sektorin publik, kurse kompanitë nga sektori privat duhet ta rrisin pjesëmarrjen e tyre dhe të jenë më të konkurueshëm. Sa i përket sektorit privat dhe atij rezidencial, ministria pret dhjetëra miliona investime të reja. Përveq kriterit të përgatitjes më të lartë, bashkëpunimi mes sektorit privat, bankave dhe institucioneve mikrofinanciare do jetë kyç, për cka edhe kanë filluar diskutimet me Fondin për Eficiencë të Energjisë.

Zëvendësministër Hysen Durmishi, MMPHI, listoi disa nga projektet aktuale që është duke i zhvilluar ministria e MMPHI-së, e të cilat i kontribuojnë biznesit në Kosovë, e ato janë:

- a. *Infrastruktura rrugore*: Vazhdojnë punimet infrastrukturore të rrugëve siç janë ato Prishtinë-Podujevë, Prishtinë-Gjilan, Prishtinë-Mitrovicë. Kurse gjatë muajit prill 2024 është nënshkruar kontrata dhe ka filluar puna për rrugën Prishtinë-Pejë dhe në segmentin Kijevë-Dollc, si dhe pas vendimit për shpronësim do të fillojnë procedurat edhe për segmentin Dollc-Zahaq. Është hapur thirrje publike për komunat e Kosovës për projekte infrastrukturore në shumë prej 17 milionë Euro, që do të ketë ndikim të konsiderueshëm në aspektin zhvillimor, ku kanë fituar 28 komuna. Po ashtu kanë filluar punimet për rrugën Kërstec-Pakizhe-Zapogj, sipas marrëveshjes mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë; Është shpallur tenderi për dizajn preliminar për linjat hekurudhore Fushë Kosovë-Klinë-Pejë me gjatësi prej 81km si dhe Klinë-Prizren me gjatësi prej 58km; Është themeluar Këshilli për Komunikacion Rrugor.
- b. *Fusha e mjedisit*: MMPHI ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me MCA Kosova, për mbështetjen e politikave klimatike në kuadër të programit kompakt; është themeluar Task Forca e Gjelbër për përmirësimin e gjendjes së lumenjve, reduktimin e mbeturinave plastike dhe veprime tjera për parandalimin e degradimit mjedisor; është miratuar plani i menaxhimit për parkun kombëtar në Bjeshkët e Nemuna; është hapur procedura e prokurimit për pastrimin e shtretërve të lumenjve; janë në fazën finale të përzgjedhjes së administratorit për sistemin e rimbursimit të depozitave; është duke vazhduar puna përgatitore në fillimin e realizimit të projektit për ndërtimin e ndërtesave për banim të përballueshëm.

Pjesa e dytë e diskutimit

Zhvillimi i fuqisë punëtore

Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI, thekson se një nga çështjet prioritare për sektorin privat, por edhe Qeverinë, është zhvillimi i fuqisë punëtore. Në linjë me këtë, ftoi znj. Vjollca Cavolli që të prezantojë një iniciativë të projektit të USAID, së bashku me Shoqatën e Teknologjisë Informative të Kosovës (STIKK), për stimujt për zhvillimin e fuqisë punëtore.

Vjollca Çavolli, STIKK, informoi pjesëmarrësit se, përmes asistencës së projektit të USAID që angazhohet në zhvillimin e fuqisë punëtore përmes sektorit privat, është përgatitur një dokument iniciues për të ndërtuar një koncept dokument lidhur me stimujt tatimor për zhvillimin e fuqisë punëtore. Deri te kjo iniciativë është arritur pas diskutimit edhe me përfaqësues të sektorëve të tjerë.

Ajo njoftoi se legjislacioni në fuqi i njeh disa stimuj tatimorë, por se sektori privat nuk i konsideron të mjaftueshëm, e konsideron se nuk përkojnë me realitetin. Sipas Ligjit për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, shpenzimet edukative-arsimore trajtohen si shpenzime të zbritshme. Megjithatë, këto shpenzime trajtohen si tilla vetëm nëse paguhen nga punëdhënësi në institucionet arsimore të licencuara nga qeveria e Kosovës.

Sipas znj. Çavolli, një disavantazh i formulimit aktual të ligjit është se edukimi i një punëtori në vendin e punës konsiderohet i lidhur ngushtë me vendin e tij të punës, duke mos lënë hapësirë për avancim apo zhvillim të mëtutjeshëm të atij punëtori për ndonjë vend potencial të punës. Disavantazhi i dytë, sipas sektorit privat, njëkohësisht më i vrazhdi, është kërkesa që punëtori të vazhdojë punën te punëdhënësi për të paktën 24 muaj. Në të kundërtën, nëse punëtori e lëshon atë vend punës, punëdhënësi është i detyruar të paguajë tatim në të ardhurat e korporatës.

Si pjesë e kësaj iniciative, është bërë analizë krahasuese në shtetet evropiane dhe ato të rajonit për çështjen e njejtë. Nga këto, modeli i Kroacisë është konsideruar si modeli më i përshtatshëm për të ndjekur si shembull për zhvillimin e fuqisë punëtore në Kosovë. Legjislacioni kroat përqindjet e stimujve tatimorë i shkallëzon bazuar në madhësinë e ndërmarrjeve. Elementi tjetër karakteristik, i cili është edhe më i përshtatshëm për aplikim në Kosovë, është kategorizimi sipas sektorëve prioritarë, pra, aplikohen stimujt tatimorë për të zhvilluar më tepër këta sektorë. Si shembull, për edukimin e mëtutjeshëm në aspektin digjital, me qëllim të stimulimit të këtij zhvillimi, legjislacioni kroat parasheh 100% zbritje.

Znj. Çavolli rekomandoi që Ministria e Financave të bëhet bartëse e kësaj iniciative. Ajo kërkoi një zotim prej Ministrisë që të punohet së bashku drejt këtij qëllimi, edhe me projektin e USAID, përmes organizimit të grupeve punuese konkrete. Kështu, do të analizohej në mënyrë të detajuar çfarë hapa të ndërmerren, e të arrihet deri te zhvillimi i koncept dokumentit sipas procedurave në fuqi. Sugjerimi i znj. Çavolli ishte që këta stimuj të arrihen ose duke amandamentuar ligjin ekzistues apo përmes krijimit të një ligji të ri, meqenëse është çështje që ndikon në secilin sektor.

Ministër Hekuran Murati, MFPT, shprehu vullnetin dhe mundësinë për bashkëpunim, me qëllim që të gjendet mënyra më e mirë për të adresuar kufizimet që ekzistojnë me ligjin aktual.

Ministri u pajtua se sidomos me ecjen përpara të teknologjisë informative dhe trajnimeve në këtë fushë, ka ndryshuar edhe realiteti praktik rreth shkollimit formal. Ai konsideroi se ka raste në të cilat një kurs gjashtë-mujor mund të jetë më i vlefshëm dhe specifik për një pozitë pune të caktuar sesa shkollimi formal.

Sa i përket kërkesës ligjore për të vazhduar punën në fushën në të cilën është punësuar, pajtohet që të mos jetë e lidhur vetëm me pozitën aktuale, por të ketë mundësi avancimi. Megjithatë, konsideron se edhe në këto rrethana, puna duhet të jetë brenda sektorit apo industrisë së njëjtë për të cilën është trajnuar.

Ndërkaq, Ministri u pajtua që kufizimi kohor për punë prej 24 muaj të përcaktuar me ligj mund të jetë problematik dhe se Ministria është e hapur për të mbështetur sektorin privat, por që duhet të diskutohen disa parakushte, për të limituar mundësitë për abuzime. Prandaj, Ministri konsideroi se çështja e këtij kufizimi kohor duhet të lihet të adresohet në aspekt teknik nga ekspertët.

Në këtë drejtim, Ministri kujtoi se në pakon e ringjalljes ekonomike, njëra nga masat ka qenë subvencionimi i plotë për shkollimin dhe trajnimin e stafit. Megjithatë, sipas tij, këto subvencione nuk janë shfrytëzuar mjaftueshëm nga sektori privat, vetëm 79 kompani kanë përfituar nga kjo masë. Pra, konsideron se bizneset duhet të vetëdijesohen akoma më shumë për të investuar në stafin e vet.

Duke folur për Qeverinë, ai tha se kanë për qëllim që gjithë këtë proces ta lehtësojnë, por që duhet të identifikohen mekanizmat përmes të cilëve arrihet qëllimi i synuar. Ai tha se synohet të krijohet një sistem me sa më shumë mekanizma vetërregullues, ku të ketë sa më pak burokraci e barrë administrative, të jenë shërbimet digjitale, por edhe të arrihet qëllimi i synuar.

Në linjë me këtë çështje të ngritur nga sektori privat, Ministri shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar në vazhdim, sidomos edhe me ATK, pasi që kjo çështje bie më shumë në fushën e veprimit të saj.

Çështja e njohjes së humbjeve, dëmtimeve

Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI, prezantoi një çështje që është ngritur nga bizneset në forumet sektoriale si dhe në të kaluarën, e që lidhet me humbjet, avullimet, tepricat, dëmtimet shkatërrimet dhe prishjet e produkteve për qëllimeve tatimore.

Sipas z. Mehmeti, ankesa e bizneseve lidhet me mos-ekzistimin e normave standarde për njohjen e humbjeve të produkteve për shkak të karakteristikave të tyre, që do të përdreshin për zbritjen e pagesës së tatimeve si akciza dhe tatimi mbi të ardhurat. Për më tepër, ai tha që bizneset ankohen edhe për procedurat e ndërlikuara për dokumentimin e dëmtimeve, prishjes dhe shkatërrimit të produkteve të cilat ndiqen nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Sa i përket implikimeve ekonomike, ai theksoi se pasi që këto çështje veç se janë të adresuara në rajon dhe BE, mos-njohja e këtyre humbjeve (ose vështirësitë për njohjen e këtyre humbjeve) krijojnë një kosto shtesë për bizneset duke e ulur konkurrueshmërinë e tyre në tregun ndërkombëtar si dhe ndikon negativisht në perceptimin e investitorëve potencial kur konsiderojnë Kosovën.

Marrë parasysh gjendjen faktike, z. Mehmeti u fokusua në tri rekomandime përmes të cilave kjo çështje do të rregullohej:

- Nxjerrja e aktit nënligjor për normat standarde të humbjeve për shkak të karakteristikave të tyre për produktet akcizore nga ana e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Përpilimi i këtij akti nënligjor parashihet me Kodin të ri Doganor. Gjatë përpilimit të këtij akti të përfshihet edhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në rol këshillues.
- Përmes aktit të ri nënligjor për implementimin e Ligjit për Administrimin e Procedurave Tatimore, i cili pritet të përfundohet këtë vit, të thjeshtëzohet dokumentimi i dëmtimeve, prishjes dhe shkatërrimit të produkteve nga ana e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve dhe Administrata Tatimore e Kosovës.
- Të konsiderohet Ligji për Tatimin në të Ardhura të Korporatave dhe ai për të ardhura personale si bazë për krijimin e standardeve të humbjeve edhe për produktet jo akcizore të cilat do të përdoren në llogaritjen e shpenzimeve të zbritshme gjatë përcaktimit të tatimit mbi të ardhurat.

Ilir Murtezaj, ATK, fillimisht theksoi se ATK-ja ka vite që është duke zhvilluar një program për reforma ku qëllimi kryesor është përkrahja e komunitetit të biznesit duke përfshirë lehtësimin dhe digjitalizimin e shumë shërbimeve. Në lidhje me çështjen e ngritur, ai theksoi se ATK-ja është organ ligj zbatues, si i tillë duhet ti ndjek procedurat që rrjedhin nga ligji. Në lidhje me çështjen e ngritur, ai tha se ATK-ja e njeh atë humbje sa herë që ajo mund të dokumentohet. Mirëpo, ai gjithashtu theksoi se bizneset të cilat kanë dëmtime dhe shkatërrime të vazhdueshme, e kanë të vështirë të ju përmbahen kërkesave ligjore aktuale për dokumentimin e atyre humbjeve ku parashihet prania e inspektoratit të ATK-së dhe inspektoratit të tregut. Ai theksoi se miratimi i Kodit të ri Doganor dhe të Akcizave ka krijuar bazë për nxjerrjen e ndonjë akti nënligjor për përcaktimin dhe definimin e humbjeve edhe nga aspekti i industrive. Ai tha që është e rëndësishme që ky akt nënligjor të pamundësojë abuzimin me humbjet reale nga ana e bizneseve. Në fund, ai theksoi që ekipi i ATK-së është i gatshëm të ofrojë ekspertizën e tij dhe të përfshihet në grupe punuese për nxjerrjen e akteve të tilla.

Agron Llugaliu, Dogana e Kosovës, tha se Dogana e Kosovës ka realizuar reforma të theksuara për lehtësimin e tregtisë, veçanërisht në dy vitet e fundit. Sa i përket pjesës së humbjeve, ai theksoi se në procedurën e importit dhe regjimit të pezullimit të detyrimeve, në përgjithësi edhe kodi

aktual e mundëson këtë. mirëpo normat përcaktohen në bazë të autorizimeve duke u bazuar në normativ që paraqiten nga subjektet që ju nënshtrohen këtyre autorizimeve. Në lidhje me Kodin e ri Doganor, ai theksoi që për dallim nga kodi aktual ky kod e ka paraparë një dispozitë të veçantë tek produktet akcizore kur pritet të nxirret një udhëzim administrativ nga ana e Ministri të Financave për të përcaktuar më saktësisht këtë pjesë të normave standarde të humbjeve për produkte akcizore.

Ministri Hekuran Murati, MFPT, shtoi se kjo çështje është ngritur për një kohë të gjatë nga bizneset. Më tutje ai theksoi se Ministria e Financave ka qenë duke punuar me GIZ-in dhe BE-në ku është ofruar një ekspertizë dhe është përgatitur një raport për këtë çështje. Sipas z. Murati, analiza e kësaj çështje duhet të ndahet në dy pjesë, së pari humbja gjatë transportit që duhet të trajtohet nga Dogana, dhe së dyti humbjet brenda territorit të vendit që kanë të bëjnë me procesin e prodhimit, përpunimit apo shitjes të cilat duhet të rregullohen nga aspekti tatimore. Ai shtoi se Ministria e Financave veç se ka filluar me trajtimin e kësaj çështje, por u shpreh i hapur për përfshirjen edhe të palëve të tjera për ti shikuar praktikrat më të mira në mënyrë që të ofrohet një zgjidhje adekuate.

Në fund, z. **Artan Mehmeti** shprehu gatishmërinë për ofrimin e mbështetjes për trajtimin e kësaj çështje edhe nga ana e Sekretariatit.

Ministre, Rozeta Hajdari, MINT, prezanton për themelimin e parqeve industriale dhe teknologjike të reja dhe funksionalizimi i parqeve ekzistuese të themeluara dhe të ertifikuara.

Ministrja tha se qëllimet kryesore të parqeve industriale janë krijimi i një ambienti fizik me një infrastrukturë përcjellëse për bizneset vendore dhe ndërkombëtare, tërheqja e investimeve të reja vendore dhe ndërkombëtare, zgjerimi i kapaciteteve të ndërmarrjeve industriale ekzistuese, krijimi dhe ofrimi i mundësive të reja për qasje në tregun e punës si dhe rritja e prodhimit të konsumit vendor dhe ulja e bilancit tregtar mes importit dhe eksportit vendor. Për zbatimin e këtij ligji i kemi të zotuar në buxhet të këtij viti dhe dy vjetët në vijim 33 milionë Euro për ndërtimin e parqeve industriale, teknologjike dhe inkubatorëve të biznesit.

Ministre Hajdari njofton për themelimin e parqeve industriale dhe teknologjike të reja dhe funksionalizimin e atyre ekzistuese që kanë qenë të certifikuara për gati 10 vjet, por të pandërtuara, si dhe për ato aktivitete tjera që ka punuar Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përgjatë viteve 2021-2024:

- Në bashkëpunim me komunën e Suharekës kemi finalizuar investimet në ndërtimin e infrastrukturës fizike të parkut industrial në Shirokë (163 ha). Po ashtu është realizuar pagesa fillestare në vlerë prej 257,000 Euro në vitin 2021 dhe është në shërbim të bizneseve.

- Në bashkëpunim me komunën e Vushtrrisë është finalizuar investimi në ndërtimin e infrastrukturës fizike (14.86 ha), ku punimet kanë përfunduar në vitin 2022, është bërë pranimiti teknik i punimeve dhe është realizuar pagesa përfundimtare në vlerë prej 167,000 Euro. Ky park i është dorëzuar komunës së Vushtrrisë dhe është gati për përdorim të menjpërdimshëm për inagurim dhe t'u jepet për shfrytëzim bizneseve.
- Në nëntor 2023 ka përfunduar inaugurimi i parkut industrial në Viti (15.50 ha), me investime në vlerë prej 563,000 Euro. I është dorëzuar komunës së Vitisë dhe është i gatshëm të jepet për shfrytëzim bizneseve.
- Në dhjetor 2023 është përfunduar inkubatori i biznesit në Malishevë. Është bërë pranimiti teknik i punimeve dhe i është dorëzuar komunës së Malishevës dhe është i gatshëm për inagurim dhe të jepet për shfrytëzim për biznese. Vlera totale e projektit ka qenë 270,000 Euro.
- Nga viti 2021 kemi vazhduar punimet në Qyragë të Lipjanit në ndërtimin e infrastrukturës fizike në parkun industrial me sipërfaqe prej 56 ha. Në vitin 2022 MINT ka ndarë buxhet prej 600,00 Euro ku edhe në vitin 2024 është duke u investuar afro 1 milion Euro.
- Parku industrial në Opatovc të Rahovecit (34,89 ha) ku ka qenë i certifikuar për shtatë vjet. Punimet për herë të parë kanë filluar në vitin 2023, të mbështetura në vlerë prej 1,5 mil Euro nga KIESA, kurse në vitin 2024 ministria ka ndarë edhe 1 milion Euro shtesë me qëllim të funksionalizimit të plotë të parkut.
- Parku industrial në Frashër të Mitrovicës me sipërfaqe prej 47 ha, në vlerë prej 1.1 mil Euro. Po ashtu përmes KIESA-s kemi njoftuar që komuna të sjellë edhe projektin edhe paramasën që sa më shpejtë të tenderohet ky projekt investiv.
- Në prill 2024 kemi kompletuar dhe themeluar parkun e përgjithshëm në Livadicë të Podujevës (29.8 ha), në vlerë prej afro 4 mil Euro.
- Parku industrial 2 në Drenas që po planifikohet të ndërtohet përballë parkut të biznesit aktual, ka një sipërfaqe prej 36 ha. Vlera do të jetë 5 milion Euro e investimi kapital. Po ashtu me këtë park do të ndërtohet edhe një impiant modern i cili do të integrojë dy parqet industriale atë të parkut industrial Drenas 1 dhe 2. Sipas studimit, vlera e këtij impianti është rreth 4 milion Euro. Të dyja këto në vlerë prej 9 milion Euro pritet të tenderohen pas marrjes së pëlqimit nga MMPHI.

Për të afruar sa më shumë bashkëpunimin me institucionet e arsimit të lartë dhe për të qenë në funksion të ngritjes të kapaciteteve njerëzore dhe të zhvillimit të inovacionit dhe ndërmarrësisë, jemi duke ndërtuar inkubatorë të biznesit dhe inkubatorë të inovacionit/qendra të inovacionit në kuadër të universiteteve.

Lulzim Rafuna, OEK, i drejtohet Kryeministrit me një pyetje rreth masave ndëshkuese, për të cilat bizneset anëtare të kësaj ode konsiderojnë se ndikojnë negativisht në raportet e tyre me bizneset partnere si dhe në mundësitë për bashkëpunim në të ardhmen.

Si pikë e dytë, i drejtohet Ministrit të Financave me një pyetje se a kanë paraparë masa në politikën fiskale, në politikën administrative për ta kthyer trendin e eksportit në rritje? Ai theksoi se importi ka kaluar gjashtë miliardë, ndërsa eksportet gjatë këtyre katër muajve na kanë rënë për 30%.

Sa i përket tregut rajonal, ai u deklarua se sektorit privat i ndihma e Qeverisë. Vendet e rajonit kanë vendosur masa administrative dhe jo administrative ndaj mallrave të Kosovës, përkundër që janë nënshkruese shumë marrëveshjeve. Edhe pse Oda Ekonomike, në kuadër të udhëheqjes së odave të Ballkanit Perëndimor po punon që këto të eliminohen, prapë ka masa që duhet të diskutohen me Ministrat, në mënyrë që ata t'i ngrisin me homologët e tyre në nivel ministror.

Nora Hasani, OEGJK, falenderoi Qeverinë për përpjekjet e tyre dhe për angazhimin në dialog publiko-privat, si iniciativë që ka munguar që shumë kohë, si dhe shprehu bashkëpunimin e ngushtë me Sekretariatit.

Znj. Hasani tha se Kosova i ka pagat më të ulëta në rajon dhe është vendi i fundit sa i përket investimeve të huaja direkte, prandaj duhet të mendohet se cka duhet të ndryshuar për të rregulluar gjendjen në këtë drejtim. Fakti se Kosova nuk është pjesë e OKB-së është disfavor në shumë për shumë procedura. Mirëpo, diçka që na shqetëson veçanërisht odat bilaterale të bizneseve, është situata politike në veri të Kosovës, pavarësisht se jemi të vetëdijshëm që kjo është çështje politike. Për shkak të lajmeve që prodhohen nga situatat e shkaktuara në veri, kjo bëhet gjithmonë temë diskutimi në takimet B2B.

U pajtua se masat e BE-së janë frikësuese për bizneset që janë investitore potenciale në Kosovë. Në linjë me këtë, ajo sugjeroi që të analizohet masa e ndalimit të importit të produkteve serbe, për shkak se ka prodhues ndërkombëtarë që prodhojnë produkte në Serbi për komplet tregun e CEFTA-s. Ka edhe shumë kompani gjermane që preken nga kjo masë.

Ajo foli edhe për programin për parandalimin dhe reduktimin e barrës administrative, si projekt shumë i mirë i Zyrës së BE-së, që udhëhiqet nga Zyra për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. OEGJK ka identifikuar disa masa që duhen diskutuar në kuadër të këtij projekti, për të cilin kanë caktuar diskutim me Zëvendëskryeministrin, i cili pastaj është ndërprerë për shkak të ngjarjes në Banjskë. Prandaj, znj. Hasani shfrytëzoi rastin që të realizohet një takim i natyrës më teknike për të diskutuar çështjet lidhur me barrë administrative.

Përndryshe, znj. Hasani tha se duhet të jemi krenarë që vitin e kaluar, 9% e GDP së Kosovës kanë qenë investime të huaja direkte, që është shumë më shumë se shtetet e rajonit. Po ashtu, ajo tha se është e kuptueshme se rritet importi kur ka investime, por momentalisht dallimi mes eksportit e importit është shumë i madh. Prandaj duhet diskutuar si të zvogëlohet ky hendek.

Arjeta Pozhegu, SHPKD, në cilësinë e përfaqësueses së shoqatës së industrinë së drurit, ngriti çështjen e rimbursimit të TVSH-së, për të cilën propozoi që të realizohet në mënyrë digjitale çdo

tre muaj, e jo përmes kontrollave të vazhdueshme në mënyrë tradicionale, siç është situata aktualisht. Znj. Pozhegu konsideroi se kjo i ndihmon bizneset prodhuese të Kosovës, të cilëve u nevojitet qarkullim vazhdimisht (mungesa e *petty cash* është një problem i madh me të cilin ballafaqohen), ndërsa qasjen në financa nuk e kanë aq të lehtë, e as kushtet për to në bankat komerciale nuk janë shumë të favorshme.

Pika e dytë të cilën e ngriti, është promovimi i Kosovës jashtë vendit, me ç'rast duhet të rishqyrtohet përqindja e lejuar e marketingut për bizneset të cilat promovohen jashtë vendit, qoftë me panairë, qoftë në mënyra tjera. Për rritjen e investimeve, znj. Pozhegu propozoi që të krijohen politika fiskale strategjike e afatgjatë, të cilat do të joshnin investitorët.

Duke shtuar në temën që u ngrit rreth trajnimeve në vendin e punës, znj. Pozhegu tha se sipas praktikës në vendet e huaja, periudha 6 muaj apo një vit sa i riu punon aty, konsiderohet trajnim, ndërsa nga pikëpamja e kompanisë kjo konsiderohet investim në të riun që trajnohet në atë profil.

Një pikë tjetër që ngriti, ishte se pavarësisht faktit se industria e drurit është profil strategjik, në Kosovë akoma nuk kemi një njësi pyjore të certifikuar. Në mungesë të një menaxhimi të mirë të pyjeve, që ndikon edhe në sigurinë e prodhuesit, kjo shumë shpejt mund të rezultojë në vështirësi. Kompanitë eksportuese të Kosovës importojnë lëndën e parë nga shtetet tjera, në mënyrë që të furnizohen me dru të certifikuar, për të bërë të mundur eksportin. Prandaj, është shumë e dobishme që të bëhet certifikimi i njësive pyjore, që të bëhet shfrytëzimi i ligjshëm i pyjeve. Mirëpo, buxheti për pyjet në vlerë prej 0.01% i buxhetit të Kosovës, kjo bëhet vështirë e realizueshme. Ajo konsideroi se është shumë e nevojshme që të kjo të kryhet në të ardhmen e afërt. Përderisa deri tani pyjet kanë qenë duke u shfrytëzuar për ngrohje, me investimet që po bëhen në energji, më nuk do t'i kemi 1.5 milion kubikë të shfrytëzuar për dru zjarri, por duhet ta përgatisim terrenin që ato të jenë dru teknik dhe ta kenë vlerën e shtuar. Konkretisht, nëse vlera e drurit të zjarrit është 60 euro/kubik, ai dru kur përpunohet vlera e një kubiku arrin edhe 500-1000 euro. Këtu shtrihet vlera e shtuar e një resursi që e kemi. Shpresoj që të ketë koordinim në këtë drejtim deri në takimin e radhës.

Hartim Gashi, PePeKo, fillimisht, u bëri thirrje pjesëmarrësve që të jenë më aktiv në Forumiks-e, ashtu që të kemi mundësi për diskutim më të thellë gjatë atyre takimeve sektoriale.

Lidhur me industrinë e përpunimit të pemëve dhe perimeve, të cilën ai e përfaqëson, ai tha se kohëve të fundit prodhuesit vendorë janë shumë të fokusuar në rritjen e eksportit, megjithatë, për shkak të kësaj, jemi duke humbur një pjesë të tregut vendor. Në linjë me këtë, ai shtoi se një prej problemeve madhore që po e pengon ekonominë prodhuese në Kosovë është raporti i të bërit biznes me shitësit ose me rrjetet e shitësve vendorë. Kjo është temë e ndjeshme, por që ua vështirëson shumë punën prodhuesve të Kosovës. Këtu z. Gashi propozon që kjo çështje të

adresohet përmes Ligjit për Tregti të Brendshme ose Ligjit për Sistemin e Pagesave, në mënyrë që të vendoset një procedurë standarde e procedurës së pagesave.

Kryeministri Albini Kurti, Kryesues, KKEI, theksoi se Qeveria bën politika, pra, ligj dhe strategji për ta përmirësuar mjedisin e të bërit biznes dhe mekanizmat përkatës zbatues. Në linjë me këtë, përmendi se Ligji për Investime të Qëndrueshme, i miratuar në Qeveri në janar të vitit 2023, e pastaj në Parlament në tetor 2023, është dërguar në Gjykatën Kushtetuese nga një parti opozitare dhe tani bëhen 7 muaj dhe ende nuk kemi përgjigje.

Kryeministri Kurti tregoi se Qeveria ka bashkëpunim të ngushtë përgjithësisht me mbi 15 asociacione të biznesit dhe 5 institucione ndërkombetare në Kosovë, të cilët e kanë synim përkrahjen e zhvillimit të sektorit privat, si dhe me përfaqësues të mbi 100 kompanive më konkurrense në vend. Pa dyshim që këto takime është mirë të zhvillohen edhe në formate të tjera edhe më shpesh, prandaj të gjitha ministrinë edhe institucionet e tjera të sistemit shtetëror janë të hapura për bashkëpunim me sektorin privat e përfaqësuesit e tyre.

Takimet e Forumiks mbahen çdo tre muaj me asociacionet e biznesit dhe me projektet relevante të donatorëve, me ç'rast kemi identifikim të mbi 130 çështjeve të ngritura nga sektori privat. Ndër to janë stimujt tatimor për zhvillimin e fuqisë punëtore, rregullimi për kallot (humbjet), largimi i lejes së eksportit për produktet medicinale, sfidat në qasjen në rrejtin e energjisë elektrike, funksionalizimi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale e kështu me radhë.

Kryeministri sugjeroi që, bashkarisht, të përpiqemi ta vëmë theksin edhe tek një aspekt sociokulturor të popullsisë të ne - të zgjerimi industrial i ndërmarrjes dhe jo thjeshtë tek përfitimi financiar i pronarit. Sepse kryefjala e zhvillimit ekonomik të ne nuk është më punësimi, por produktiviteti. Pra, theksohet nevoja për rritje të produktivitetit, dhe kjo është lidhur sa me modernizimin e teknologjisë, po aq edhe me shkathtësitë e fuqisë punëtore, dhe ky produktivitet pa dyshim që përkthehet menjëherë në konkurrueshmëri edhe në tregun vendor edhe atë rajonal, evropian dhe global.

Për fund, duke iu referuar pyetjeve të ngritura nga shoqatat e biznesit, Kryeministri foli për deeskalimin e situatës në veri të vendit, e sidomos pas rastit të sulmit terrorist në Banjskë, ku u vra rreshteri Afrim Bunjaku dhe u konfiskuan mbi 5 milion Euro armatim që ishin sjellë në Kosovë për një konflikt më të zgjeruar dhe më të gjatë në kohë. Nuk ka dyshim as tek partnerët ndërkombëtar se kush ka qenë shkaku i eskalimit dhe kush është faktori i rrezikut. Në verën e vitit të kaluar është kërkuar tërheqja e kryetarëve në komunat në veri të Kosovës për çka kam qenë kundër. Është mundësuar zbatimi i nenit 72 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, ku me 21 prill patëm votimin i cili nuk ishte i suksesshëm dhe tash ata katër kryetarë ngelen në detyrat e tyre. Në fund tash i kemi mbyllur rrugët ilegale ku i kemi stacionet policore në zonat kufitare dhe kur

lighshmëria, kushtetueshmëria, rendi, ligji, siguria, paqja janë aty, ndoshta jo ende si në pjesët e tjera të Kosovës, por me një lloj kapërcimi pa dyshim edhe sasior edhe cilësor.

Ministër Hekuran Murati, MFPT, në lidhje me rritjen e vlerës së importit, tha se shifrat e larta të importit kanë qenë dhe janë shqetësuese edhe për këtë Qeveri. Megjiuthatë rritjen e importit në 2-3 vitet e fundit ai ja atribuon në një masë edhe rritjes së formalitetit dhe deklarimit të importit. Për më tepër ai sqaron se qeveria nuk ka shumë hapësirë në intervenim sa i përket importit pasi që orientimi është drejt tregtisë së lirë, në mënyrë që të rritet edhe konkurrueshmëria. Sa i përket bizneseve, ai theksoi se Qeveria ka ofruar masa mbështetëse për lehtësimin e të bërit biznes, lehtësimin e punës së prodhuesve dhe nxitjen e eksportit.

Po ashtu, ai u fokusua edhe tek qasja në financa për bizneset, si një aspekt i rëndësishëm në të cilin ka punuar Qeveria. Së pari z. Murati komentoi marrjen e *Credit rating* si një e arritur shumë e rëndësishme sa i përket qasjes në financa, pasi që do të ndikojë në uljen e çmimit të financimit. Pastaj, u fokusua edhe në zhvillime tjera që kanë ndikuar në rritjen e qasjes në financa si rritja e fondit kreditor, si dhe masat mbështetëse të Qeverisë për subvencionimin e kredive investive. Gjithashtu ai theksoi se Qeveria përmes menaxhimit të borxhit publik duke u fokusuar në financim nga jashtë ka ndikuar që sektori financiar në Kosovë të ketë mundësi të ofroj kreditim për ekonominë në tërësi duke ja hequr barrën për financimin e borxhit të shtetit.

Sa i përket punësimit, z. Murati tregoi që Qeveria e ka mbështetur punësimin, sidomos të grave, përmes subvencionimit. Po ashtu ai theksoi se lansimi i platformës “Superpuna” ka ndikuar pozitivisht në rritjen e punësimit të të rive.

Z. Murati gjithashtu theksoi që në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë kanë ndihmuar bizneset në përballimin e luhatjeve të jashtme të çmimit të energjisë përmes pakos mbështetëse.

Poashtu, ai theksoi së është e rëndësishme të nxitet edhe eksporti i shërbimeve pasi rezultatet mund të vërehen më shpejt. Ai tha se Qeveria ka ofruar masa mbështetëse sa i përket nxitjes së eksportit të shërbimeve. Për shembull, ofrojmë bursa për vajza dhe gra në fushat STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Matematikë). Këto masa mbështetëse synojnë të krijojnë një ekosistem për njerëzit me talent dhe aftësi të nevojshme për të kontribuar në zhvillimin dhe rritjen e eksportit të shërbimeve.

Pas kësaj, z. Murati komentoi edhe situatën e pagave në Kosovë krahasuar me rajonin. Ai theksoi që nëse shohim situatën në Republikën e Shqipërisë, në dy vitet e fundit kemi parë rritje në pagat në Euro, edhe në rastet kur, në Lekë, nuk ka pasur ndonjë rritje të vërtetë. Kjo rritje kryesisht është rezultat i ndryshimeve në kursin e këmbimit. Kështu, edhe pse pagat duket të kenë rritje në euro, në realitet, nuk ka ndodhur ndonjë ndryshim në vlerën e pagave në monedhën lokale. Një situatë e ngjashme shihet edhe në Republikën e Maqedonisë Veriore. Nëse krahasojmë pagat bruto në

sektorin publik, ato mund të jenë pak më të larta në krahasim me Kosovën, por pagat neto në fakt janë më të larta. Kjo është për shkak se taksat dhe kontributet sociale në Maqedoni janë mesatarisht tridhjetë e tre për qind e pagës bruto, ndërsa në vendin tonë janë vetëm 11% e pagës bruto. Kjo do të thotë se qytetarët ose punëtorët në sektorin publik në Kosovë marrin paga më të larta në fund të muajit në krahasim me vendet e tjera të rajonit.

Nora Hasani, OEGJK, lidhur me platformën “Superpuna”, propozoi që si kategori e veçantë të futen edhe gratë e moshës mesme (katërdhjetë deri në gjashtëdhjetë e pesë vjeç). Ajo tha që në një raport të publikuar nga OEGJK, është identifikuar një potencial i madh për punësim në këtë grupmoshë, marrë parasysh vullnetin e tyre të madh për punë, pasi që kanë qenë jashtë tregut të punës për një kohë të gjatë.

Illir Murtezaj, ATK, u lidh me temën e rimbursimit të TVSH-së, e cila u ngrit nga SHPKD. Ai tha se ATK-ja ka kryer shumë reforma gjatë këtyre viteve, përfshirë edhe pjesën e kërkesave nga ana e tatimpaguesve për rimbursim, duke digjitalizuar krejtësisht procesin e kategorizimit të kërkesave për rimbursim. Tregoi se sistemi elektronik i ATK-së kategorizon të gjitha kërkesat për rimbursim në kategoritë A, B dhe C, varësisht nga niveli i rrezikut. Kjo do të thotë që tatimpaguesit që kërkojnë rimbursim për tatime pa të cilat kanë rreziqe minimale për mosplotësim, marrin rimbursimet e tyre brenda shtatë ditësh. Ata që kanë rreziqe të mesme për mosplotësim, marrin rimbursimet brenda pesëmbëdhjetë ditësh, ndërsa ata që kanë rreziqe më të larta, në të cilët është e nevojshme të bëhet një kontroll i detajuar, marrin rimbursimet e tyre pas një procesi të saktë vlerësimi, që mund të zgjasë më shumë kohë. Gjithashtu, mesatarja e trajtimit të të gjitha kërkesave të parashtruara brenda një viti nga ana e institucionit tonë është 20 ditë, e cila është më e ulët se koha prej 30 ditëve që parashihet me ligji.

Zana Beqiri, DhTIK, e ngriti çështjen e Ligjit për Sponzorizim. Ajo theksoi që përderisa ligji përkrah kulturën dhe sportin, në të ardhmen duhet të përfshijë edhe mekanizma për financimin e inovacionit dhe kërkimeve shkencore. Vendet e ndryshme në Evropë, përpos subvencionimit të të punësuarve, kanë krijuar mekanizma për financimin e kërkimeve shkencore. Bizneset vendore, veçanërisht prodhuesit, duhet të favorizohen, dhe mund të krijohen mekanizma të veçanta përmes universiteteve apo institucioneve të larta arsimore që ata të ndihmohen në inovacion dhe kërkime shkencore.

Lidhur me këtë, **Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Z. Murati** tha se, me sa ai është në dijeni, është duke u zhvilluar një proces i auditimit dhe i vlerësimit të zbatimit të Ligjit për Sponzorizim dhe analizim nëse ky ligj ka arritur synimet që i ka. Ai shtoi se në momentin që finalizohet raporti edhe me vlerësimet nga ana ATK-së, do të vlerësohet se çka është e nevojshme të bëhet për të vazhduar tutje.

Pas Ministrisë, fjalën e mori **z. Rafuna nga OEK**, i cili shprehu gatishmërinë e plotë që të bashkëpunojë me Qeverinë drejt përmirësimit të të bërit biznes në Kosovë.

Ministre Rozeta Hajdari, MINT, falenderon bizneset dhe shoqatat industriale për kontributin e tyre në hartimin e politikës industriale që është një strategji shumë ambicioze. 15 e më shumë sosh kanë qenë pjesë e shtatë forumeve për zhvillim të politikës industriale. Ministrja shtoi se industria e Kosovës ende nuk e ka shpalos potencialin për të qenë kontribues shtytës për zhvillim social, ekonomik dhe mjedisor. Me kontributin e me bashkëpunimin e të gjitha ministrive respektive, arrihet ky potencial. Ndër tjera, këtu përfshihet MFPT, ME, MBPZhR, por, edhe MASHT, meqë tani si aktivitet i parë i politikës industriale është finalizimi i studimit të thellë për arsimin profesional, ku pritet një kontribut më i madh nga sektori privat në arsimin dual dhe reformim më i shpejtë i profileve të arsimit sipas nevojave të industrisë.

Poashtu, shpjegoi përkrahjen e 499 bizneseve për të lehtësuar dhe rritur eskportin, duke ndihmuar në avancimin e makinerisë, certifikimin, standardizimin, trajnimin dhe digjitalizimin. Po ashtu, 33 milion Euro janë nga ato 1,000 kredi në vlerë prej 67 mil Euro për afër 1,000 biznese. Pastaj, me masën 2.1 janë përkrahur 450 biznese në vlerën që përmendi Ministri Murati - 12.4 mil Euro. Për rritjen dhe lehtësimin e eksportit, ne kemi përfshirë Kosovën në programin *EU Single Market*, si programi më i madh i BE-së që synon rritjen e konkurrueshmërisë, përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla, mbikëqyrjen e tregut dhe më shumë. Ministrja përmendi edhe finalizimin e marrëveshjes EFTA, ku Kosova është vetmja në Ballkanin Perëndimor që ka përfshirë edhe tregtinë e shërbimeve, përveç atë të mallrave. Për rritjen e konkurrueshmërisë së bizneseve, Ministrja theksoi se kanë shtyrë 20 ligje që i kontribuojnë ambientit të të bërit biznes në Kosovë, sukses i përmendur edhe në raportin e progresit të BE-së.

Sa i përket çështjes së ngritur nga PePeKo për raportet prodhues-tregtarë, Ministrja tha se Ligji për Tregtinë e Brendshme do ta rregullojë këtë çështje, e nuk do të ketë më pritje të gjata nga tregtarët siç ka qenë situata deri tash.

MIINT dhe MASHT, së bashku kanë finalizuar Ligjin për Inovacion dhe Ndërmarrësi. Tani MINT po investon në qendrat për inovacion në kuadër të universiteteve, ndërsa MASHTI me fondin e shkencës, me qëllim që të ofrohet sa më shumë bashkëpunimin akademi-qeveri dhe sektor privat dhe për të krijuar ekosistemin në fushën e inovacionit e ndërmarrësisë.

Për më tepër, Ministrja theksoi se, sipas raportit preliminar të OECD, Kosova paraqitet si e para në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi me klimën e politikave për investime, tregti, sistem fiskal, tatimor, dhe ato në bujqësi. MINT ka ndihmuar në promovimin e bizneseve për pjesëmarrje në shumë panaire, e deri më tani në 41 sosh. Shfrytëzon rastin t'u bëjë thirrje përfaqësuesve të sektorit privat që të ofrojnë edhe më shumë rekomandime në Këshillin Kombëtar për Zhvillim Industrial.

Për fund, Ministrja Hajdari tha se është finalizuar Ligji për Odën Ekonomike, me ç'rast pritet nga të gjithë të ofrojnë kontributin e tyre proaktiv. Ajo shtoi se Qeveria po përpiqet të shpalosë

potencialin e industrisë, të inovacionit dhe të turizmit. Turizmi ka qenë një sektor krejt i heshtur, ndërsa tani me ligjet e reja përkatëse për turizmin e politikën për turizmin, po zhvillohen mundësitë për Kosovën si destinacion turistik.

Ministre, Artane Rizvanolli, ME, ndërlidhet me çështjen e zinxhirit të furnizimit në sektorin e përpunimit të drurit që e ngriti znj. Pozhegu. Ajo tha se është me rëndësi të bëhet një diskutim i natyrës së ngjashme, por për shkak të prodhimit të biomasës për ngrohje që kam pasur me disa ekspertë, konsideroj që kjo është një ndër ato fushat ku asistencë teknike do të ishte shumë e dobishme për të identifikuar një *roadmap* për hapat të cilët duhet ti ndërmarrim.

Sa i përket çështjes së efektit të ngjarjeve në veri ose më saktësisht lajmeve që prodhohen nga veriu, Ministrja ndau përvojën e tyre me ankandin solar. Afati paraprak ka qenë diku më 4 tetor 2024, diku një javë pas sulmit në Banjskë, me ç'rast është vërejtur ndikimin e kësaj ngjarje, por veçanërisht tek kompanitë të cilat nuk janë aktive në Kosovë. Kjo është përkthyer në angazhim shtesë për ta promovuar ankandin, për të pasur kontakt direkt me investitorët potencial për ta sqaruar situatën, dhe ajo konsideroi se rezultati në fund me gjashtë investitorë potencial, tre prej të cilëve kanë qenë të rinj, ka treguar që ka pasur sukses.

Për fund, duke u lidhur me diskutimin për situatën në veri, Ministrja tha se fakti që komunat veriore nuk kanë qenë në lajme nuk do të thotë se gjërat kanë qenë mirë. Ka qenë burim i kontrabandës, informalitetit, krimit të organizuar rrjedhimisht edhe konkurrencës jo fer. Skemat kane dështuar, në rajonin e Mitrovicës, sepse nuk arritur që kompanitë formale të konkurrojnë me kompanitë nga veriu që nuk kanë paguar madje as energjinë elektrike. Të gjitha këto janë me rëndësi që të shihen nga të dyja anët për një qartësim më të mirë të situatës se çfarë po ndodh në realitet.

Ministre Rozeta Hajdari, MINT, lidhur me Rregullat e Punës dhe Procedurat e KKEI, ngriti çështjen lidhur me pavarësinë e Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime, për të cilin tha se MINT konsideron se duhet të jetë pjesë e Zyrës së Kryeministrit, por asesi trupë e pavarur. Ministrja shtoi se fakti se Sekretariati mbështetet nga partnerët ndërkombëtarë, nuk duhet të luajë rol në pavarësinë e Sekretariatit, meqenëse edhe vetë Ministria ka përkrahje nga akterët ndërkombëtarë. Për fund, ajo tha se Ministria është llogaridhënëse tek të gjithë, por së pari tek Qeveria e Kosovës, dhe se synojnë që Qeveria të avancojë dialogun publiko-privat.

Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI, falenderoi pjesëmarrësit dhe i fton të përgatiten për takimin e radhës të KKEI. Meqenëse diskutimi i sotëm zgjati më shumë sesa u prit, dhe nuk arritëm të aprovojmë Rregullat dhe Procedurat e punës së KKEI, të njëjtat do të shohim t'i aprovojmë në mënyrë elektronike.

Angazhimi i Sekretariatit të KKEI deri në takimin e radhës:

- Koordinimi rreth çështjes për stimujt tatimorë për zhvillimin e fuqisë punëtore.
- Përcjellja e angazhimeve të institucioneve publike përkatëse lidhur me çështjen e humbjeve, avullimeve, tepricave, dëmtimet shkatërrimet dhe prishjet e produkteve për qëllimeve tatimore.
- Monitorimi i implementimit të heqjes së lejes së eksportit nga AKPPM dhe Dogana e Kosovës.

LISTA E PJESËMARRËSVE

Përfaqësuesit nga institucionet publike:

1. Kryeministri, kryesues;
2. Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog;
3. Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
4. Ministrja e Ekonomisë;
5. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve;
6. Shefi i Stafit të Kryeministrit;
7. Zëvendësministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
8. Përfaqësues i Bankës Qëndrore të Kosovës;
9. Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës;
10. Drejtori i Përgjithshëm i Doganës të Kosovës;
11. U.D. Drejtor i Përgjithshëm i KIESA;

Përfaqësuesit nga odat dhe shoqatat e bizneseve:

12. Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike të Kosovës;
13. Drejtorja Ekzekutive e Odës Ekonomike Gjermano – Kosovare;
14. Drejtori Ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropian;
15. Nënkryetarja e Dhomës Ekonomikë të Grave të Kosovës - G7;
16. Drejtorja Ekzekutive e Shoqatës së Përpunuesve të Drurit të Kosovës (SHPKD);
17. Drejtorja Ekzekutive e Asociacionit të Kosovës për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit (STIKK);
18. Drejtori Ekzekutiv i Kllasterit të Industrisë së Metalit dhe Energjisë së Ripërtërishme në Kosovë (KIMERK);
19. Drejtorja Ekzekutive e Dhomës së Industrisë dhe Tregtisë - Kosovë (DHTIK);
20. Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës për përpunimin e Pemëve dhe Perimeve të Kosovës (PePeKo);
21. Drejtori i Asociacionit të Komunave të Kosovës;
22. Drejtore e Kllasterit të Ndërtimeve të Parafabrikuara të Kosovës (PREFAB);

Përfaqësuesit nga Ambasadat dhe misionet diplomatike:

23. Përfaqësues nga Ambasada Amerikane;
24. Përfaqësues nga Ambasada Britaneze;
25. Përfaqësues nga Ambasada Gjermane;
26. Përfaqësues nga Ambasada e Italisë;
27. Përfaqësues nga Ambasada e Turqisë;
28. Përfaqësues nga Ambasada e Holandës;

29. Përfaqësues nga Ambasada e Japonisë;
30. Përfaqësues nga Ambasada e Austrisë;
31. Përfaqësues nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë;

Përfaqësuesit nga partnerët ndërkombëtarë:

32. Drejtori i Zyrës së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Kosovë (BERZH);
33. Përfaqësues nga Banka Botërore në Kosovë (BB);
34. Udhëheqësi i programit të Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID);
35. Udhëheqës i Zyrës së Korporatës Ndërkombëtare Financiare në Kosovë (IFC);

Pjesëmarrës të tjerë observues:

36. Kryetari i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë;
37. Përfaqësues shtesë nga BERZH;
38. Përfaqësues shtesë nga ZKM;
39. Përfaqësues shtesë nga BQK;
40. Përfaqësues shtesë nga BB;
41. Përfaqësues shtesë nga Ambasada e Turqisë;
42. Përfaqësues shtesë nga ATK;
43. Përfaqësues shtesë nga OEGJK;
44. Përfaqësues shtesë nga ME;
45. Përfaqësues shtesë nga zyra e Zëvendëskryeministrit;
46. Përfaqësues shtesë nga Oda Ekonomike e Kosovës;

SHKURTESAT E PËRDORURA

KKEI – Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime

OEK – Oda Ekonomike e Kosovës

OEGJK – Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare

STIKK - Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës

SHPDK – Shoqata e Përpunuesve të Drurit të Kosovës

ZKM – Zyra e Kryeministrit

ZPS – Zyra për Planifikim Strategjik

BQK – Banka Qëndrore e Kosovës

ATK – Administrata Tatimore e Kosovës

DK – Dogana e Kosovës

EFTA – Shoqata e Tregtisë së Lirë Evropiane

CEFTA - Marrëveshja e Evropës Qëndrore për Tregti të Lirë